



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 58/2012
Prishtinë, më 13.04.2012, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Sala Berisha – Shala, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija dhe Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Ramadan Sejdiu dhe Alban Çollaku –MZHE; Ibrahim Gjylderen – ZAP; Bajram Geci dhe Sade Ouksi – Ambasada e SHBA- së; Burim Ejupi- INDEP; dhe Florije Mehmeti– KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Visar Ymeri – Theksoi se në këtë formë se si është thirrur kjo mbledhje pa kurrfarë arsye urgjente përbën shkelje të Rregullores së Kuvendit. Sepse sipas Rregullores mbledhja thirret 4 (katër) ditë para se të mbahet, ndërsa ne e kemi marr informacion dje pasdite që mbledhja të mbahet sot.

Lutfi Zharku – Theksoi se nuk ka kushte që të mbahet mbledhja sot për shkak se nuk kemi urgjencë edhe nuk kemi material për të shqyrtuar. Sepse tani me sa ka përfunduar punën Grupi punues dhe ne nuk e kemi një raport nga ky grup. Dhe, në fund, kërkoi që në mbledhjen e radhës që e kemi të përfshihet në rend dite kjo pikë.

Kryetari – E sqaroi se pse e ka thirrur këtë mbledhje si: 1. për shkak së është projektligji i fundit që përmbyll procesin e Pavarësisë së Kosovës, dhe 2. për shkak së kemi informacion se javën e ardhme ky projektligj parashihet të futet në seance.

Pas debatit kryetari kërkoi 10 (dhjetë) minuta pauzë që të konsultohet zyra ligjore në lidhje me këtë çështje.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Kryetari – I njoftoi deputetët që në bazë të Rregullores të Kuvendit, Komisioni mund të mbajë mbledhje sa herë që pajtohen shumica e anëtarëve të Komisionit ose vendoset për rendin e ditës me shumicë votash.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje me 6 (gjashtë) vota Për, asnjë Kundër dhe asnjë Abstenim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike

Kryetari – Ia kaloi fjalën raportueses së Grupit punues për Projektligjin Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, që t'i prezantojë amendamentet.

Myzejene Selmani – Theksoi se Grupi punues ka mbajtur sot një takim dhe kanë qenë deputet të interesuar, si nga Komisioni z. Zenun Pajaziti dhe Biserka Kostiq dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, znj. Valbona Dibra dhe z. Armend Zemaj, por sqaroi se zoti Zemaj nuk ishte prezent në takim. Pastaj prezantoi amendamentet si vijon: **Amendamenti 1** ndërhyrje teknike te Neni 2; **Amendamenti 2** ndërhyrje teknike te Neni 3, paragrafi 2; **Amendamenti 3** e plotëson Nenin 5, paragrafi 1, që ndryshon Nenin 15.1, pas fjalës “drejtor” shtohet teksti “, ku 1 (një) nga ata duhet të jetë nga komuniteti jo shumicë”, për të përfaqësuar komunitetet në vend; **Amendamenti 4** riformulon Neni 5, paragrafi 2; **Amendamenti 5** rregullon Neni 5, paragrafi 7; **Amendamenti 6**, Neni 6, paragrafi 1, në fund të paragrafit fjalës “ekspert” i shtohet “ i certifikuar”; **Amendamenti 7**, rregullim teknik te Neni 6, paragrafi 7; dhe **Amendamenti 8**, Neni 6, paragrafi 8 riformulon këtë paragraf sipas propozimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ramiz Kelmendi – Propozoi që në Nenin 5, paragrafi 2 të ndryshohet si vijon: “Komunat përkatëse duhet t'i dorëzojnë Qeverisë një numër kandidatesh të cilët i përmbushin kriteret e

përcaktuara në këtë ligj, numër i cili duhet të jetë aq sa numri i pozitave të hapura për drejtorë të rezervuar për përfaqësues të komunave”.

Propozimi me 1(një) Për dhe 6 (gjashtë) Kundër nuk u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimitisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohen amendamentet e Projektligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të propozuara nga raportuesja e Grupit punues;*

3. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit